



Monitoring Brief Nr 1 / KPIE

**Mbi punën e Komisionit Parlamentar për Integrimin Evropian
(KPIE)**

HYRJJE

“Parlamenti shqiptar nuk funksionin si një institucion i pavarur duke mos ushtruar kështu në mënyrë efektive dhe efikase detyrën e tij për monitorimin dhe kontrollin e qeverisë”

[Progres raporti i KE për Shqipërinë COM (2010) 680, faqe 12]

Ky është vlerësimi i fundit i Komisionit Evropian përsa i përket vetëm njëres prej detyrave të Parlamentit. Shqetësimet mbi cilësinë e ligjeve, konsultimeve të pakta me shoqërinë civile dhe grupet e interesit, ekspertiza dhe kapacitetet në dispozicion të komisioneve parlamentare gjithashtu përbëjnë një sfidë për Kuvendin, duhe ngritur pikëpyetje rreth shkallës së zbatimit të ligjeve.

Duke parë këto sfida si dhe në përgjigje të nevojës për të përmirësuar marrëveshjet për çështjet e Integritimit Evropian, Departamenti për Çështjet Evropiane dhe Sigurisë në IDM mori përsipër në fillim të këtij viti këtë monitorim që lidhet me performancën dhe efikasitetin e Komisionit Parlamentar për Integrimin Evropian.

Ky raport i shkurtër mbi monitorimin e lartpërmenduar mbulon gjashtë muajt e parë të vitit 2011 dhe do të ndiqet nga një raport vjetor monitorimi mbi punën dhe performancën e KPIE

METODOLOGJIA

Ky monitorim u dizajnuar fillimisht të realizohej përmes vëzhgimit direkt të mbledhjeve të KPIE nga ana e ekspertëve të IDM. Për këtë arsye në Janar 2011 IDM kërkoi në mënyrë zyrtare nga administrata e Kuvendit leje vjetore për të garantuar pjesëmarrjen e ekspertëve të saj. Deri në kohën e publikimit të këtij Monitoring Brief, kjo leje nuk u mundësua. Si pasojë grupi i punës i IDM vendosi vazhdimin e monitorimit përmes analizës së proceverbaleve të cilët publikohen rregullisht në faqen zyrtare të Kuvendit.

Monitorimi i këtij komisioni parlamentar fokusohet në këta indikatorë:

1. Prezenca e anëtarëve të KPIE në takime
2. Prezenca e përfaqësuesve të Ministrisë së Integritimit
3. Prezenca e përfaqësuesve të ministrive të ngarkuara me draftimin e projektligjeve të paraqitura në komision
4. Procedurat formale dhe Tabela e përputhshmërisë e projektligjeve
5. Përfshirja e shoqërisë civile dhe grupeve të interesit në takimet e KPIE
6. Cilësia e debateve parë nga këndvështrimi i propozimeve dhe kundërshtimeve (nga anëtarët e KPIE) në amendimin e projektligjeve apo akteve të tjera ligjore

Ky raport monitorimi pranon kufizimet metodologjike të imponuara nga fakti që bazohet vetëm në procesverbalet e takimeve të KPIE. Duke shpresuar që administrata e Kuvendit do të reflektojë në lidhje me mundësinë e dhënies së lejeve për pjesëmarrje në takimet e komisioneve, ekspertët e IDM do ta adresojnë këtë kufizim përmes kontakteve të drejtpërdrejta me anëtarë të KPIE.

Autorë: Suela Jahaj (Eksperte Monitorimi) dhe Gjergji Vurmo (Krveredaktor)

GJETJET KRYESORE

21 Janari 2011 ka ndryshuar në mënyrë thelbësore atmosferën politike shqiptare, megjithëse shumë diskutime dhe keqkuptime kanë filluar që në vitin 2009 me zhvillimin e zgjedhjeve të përgjithshme. Në gjashtëmuorin e parë të 2011 u mbajtën njëmbëdhjetë mbledhje të KPIE, mesatarisht dy për çdo muaj.

ANËTARËT E KPIE nga blloku i opozitës kanë qënë prezent vetëm në 45% të takimeve, ndërkohë që disa anëtarë kanë marrë pjesë në më pak mbledhje (afërsisht vetëm në 36% të tyre). Përgjithësisht debatet e deputetëve në komision mbeten të një niveli mesatar, ku vetëm një pjesë e anëtarëve të KPIE diskutojnë në mënyrë aktive duke propozuar amendime të ndryshme.

PËRFAQËSUESIT E MINISTRISË SË INTEGRIMIT kanë qënë të pranishm në afërsisht 73% të mbledhjeve të komisionit. Ata kanë dhënë informacione të mëtejshme rreth projektligjeve të paraqitura dhe nivelit të harmonizimit me *acquis* e BE. Në një nga takimet e KPIE ishte prezent Ministria e Integritimit, e ftuar për të diskutuar rreth 12 prioritetëve të Planit të Veprimit për Shqipërinë të paraqitura nga Komisioni Evropian. Pavarësisht progresit, bashkëpunimi mes Ministrisë së Integritimit dhe KPIE duhet të forcohet më tej.

PËRFAQËSUES TË MINISTRIVE TË LINJËS përgjegjës për përgatitjen e projektligjeve kanë qënë të pranishm në të gjitha mbledhjet e KPIE për projektligjet përkatëse.

PËRFSHIRJA E SHOQËRISË CIVILE DHE GRUPEVE TË INTERESIT në takimet e KPIE mbetet në nivele tepër të ulëta, me vetëm dy mbledhje ku shoqëria civile ka marrë pjesë (në krahasim me numrin 11 të takimeve të mbajtura në total)¹. Për më tepër përfaqësues të tjerë të grupeve të interesit dhe më specifikisht përfaqësues të sektorit privat nuk kanë marrë pjesë në asnjë prej mbledhjeve të zhvilluara nga KPIE, shtuar këtu faktit që gjatë gjashtëmuorit të parë KPIE ka diskutuar në

CËSHTJET KRYESORE

Raporti mbi Monitorimin konkludon se performanca e KPIE gjatë gjashtëmuorit të parë të 2011 ka qënë e kufizuar. Deputetët e opozitës kanë qënë prezent vetëm në 45% të takimeve. Në 11 mbledhje që janë zhvilluar nga ky komision prezenca e plotë e anëtarëve të këtij komisioni është vërejtur vetëm në 2 prej tyre.

Atmosfera e nderë politike që ka karakterizuar politikën shqiptare sidomos pas ngjarjeve të 21 Janarit, është transferuar edhe në punën e KPIE dhe në çështjet e integritimit, për të cilat deri para jo shumë kohe ekzistonte i plotë konsensus mes maxhorancës dhe opozitës në Parlament.

Pavarësisht politizimit të çështjeve teknike dhe debateve të ashpra pozitë-opozitë në mbledhjet e KPIE, vërehet se pjesëmarrja e anëtarëve të Komisionit nga rradhët e opozitës përgjithësisht ka zgjeruar cilësisht shqyrtimin përmbajtësor të çështjeve në rendin e ditës.

Përfaqësuesit e ministrive përgjegjëse për përgatitjen e projektligjeve kanë qënë të pranishm në të gjithë mbledhjet e komisionit për projektligjet përkatëse. Nga ana tjetër, përfaqësuesit e Ministrisë së Integritimit kanë marrë pjesë në 73% të mbledhjeve të KPIE.

Shoqëria civile ka qënë prezente në vetëm dy mbledhje të KPIE, dhe ka marrë pjesë në diskutimet e vetëm njëres prej tyre. Asnjë grup interesi, vecanërisht nga sektori privat, nuk ka marrë pjesë në takimet e KPIE.

¹ Sic shihet nga procesverbalet e këtyre dy takimeve (takime të mbajtura më 19.04.2011 dhe 01.06.2011), përfaqësuesit e shoqërisë civile morën pjesë në mënyrë aktive në diskutimet e vetëm njërit prej këtyre takimeve.



lidhje me projektligje të rëndësishme për sektorë si komunikimet elektronike, bujqësia, mbrojtja e konsumatorit, mbrojtja e mjedisit apo vlerësimi i ndikimit në mjedis etj.

Megjithëse monitorimi i **PROCEDURAVE FORMALE TË KPIE** e sidomos **TABELA E PËRPUTHSHMËRISË** që duhet të shoqërojë çdo projektligj fillimisht ishte pjesë e metodologjisë së monitorimit, ekspertët e IDM u detyruan të heqin dorë nga ky indikator për shkak të mosdhënies së lejes nga ana e administratës së Kuvendit, për të marrë pjesë në mbledhjet e KPIE.

CILËSIA E DEBATEVE e KPIE lidhur me projektligje të caktuara dhe akte të tjerë ligjorë në kuadër të procesit të integritetit është shqyrtuar me shumë kujdes nga grupit të monitorimit të IDM. Ky monitorim pranon pamjaftueshmërinë e nën-indikatorëve të zgjedhur – kundërshtimet dhe propozimet për amendime – për të gjykuar rreth cilësisë së shqyrtimit dhe debateve në KPIE për projektligjet apo të aktet e tjera ligjore. Një tjetër kufizim përbën edhe fakti që monitorimi bazohet vetëm në analizën e procesverbaleve të KPIE. Për më tepër, analiza fokusohet vetëm në elementë të përgjithshëm në mënyrë që të evitohet çdo lloj subjektivizmi ndërsa ankesat e mundshme për mungesë objektivizmi të mbeten në nivele minimale. Këto janë disa nga gjetjet:

Ka një dallim të qartë mes mbledhjeve të KPIE ku deputetët e opozitës ishin të pranishëm dhe atyre ku ata nuk kanë munguar. Më specifikisht, në takimet ku mungonin deputetët e opozitës, diskutimet mbeteshin të kufizuara dhe kryesisht formale. Gjithashtu numri i përgjithshëm i kundërshtimeve, amendimeve madje dhe pyetjeve për përfaqësuesit e ministrive të cilat kishin prezantuar projektligjet mbetet dukshëm i ulët. Ndryshe nga këto mbledhje të KPIE, diskutimet kanë qënë më plota kur anëtarët e Komisionit nga rradhët e opozitës kanë qënë të pranishëm. Ka patur gjithashtu një numër më të madh amendimesh të propozuara në komision si dhe diskutime mjaft konstruktive me përfaqësuesit e Qeverisë të pranishëm në takime. Duhet theksuar gjithashtu se shumë propozime që bëhen nga opozita nuk miratohen. Për më tepër, debatet mbi projektligjet politizohen lehtësisht. Në këtë skenar mund të veçohen mbledhjet e KPIE rreth Planit të Veprimtimit për implementimin e rekomandimeve të avisit të KE, ku diskutimet kanë qënë kryesisht politike dhe jo të fokusuar në çështjet teknike të rekomandimeve apo masave të parashikuara. Mungesa e një dialogu konstruktiv dhe debati i mbi-politizuar mes maxhorancës dhe deputetëve të opozitës në mbledhjet e KPIE potencialisht mund të çojë në miratimin e ligjeve me cilësi të ulët që vjen si pasojë e mungesës së një analize të detajuar ndaj problematikave të legjislacionit në fjalë.

Së fundi, shkalla e përgjithshme e përfshirjes së anëtarëve të KPIE në debate dhe diskutime, përforcon nevojën për të përmirësuar kapacitetet dhe ekspertizën e stafit mbështetës për KPIE, çka është theksuar shpeshherë në progres raportet e KE për Shqipërinë.

PROPOZIME PËR HAPAT E MËTEJSHËM...

Duke u bazuar në gjetjet e këtij monitorimi disa prej rekomandimeve në funksion të përmirësimit të punës së Kuvendit në përgjithësi dhe të KPIE në kontekstin e anëtarësimit në BE do të përfshinin:



1. Duhet marrë hapa të menjëhershëm për rritjen e aksesit të shoqërisë civile në mbledhjet e komisioneve parlamentare
2. Të inkurajohet shoqëria civile dhe sidomos grupet e interesit nga sektorët jo-shtetërorë që të përfshihen më shumë në aktivitetin e KPIE
3. Të rritet niveli i ekspertizës dhe i burimeve në dispozicion të KPIE
4. Të ndërmerren hapa të mëtejshëm për përmirësimin e koordinimit dhe bashkëpunimit mes KPIE dhe Ministrisë së Integrimit
5. Të inkurajohet përfshirja aktive e të gjithë anëtarëve të KPIE në diskutimet e mbledhjeve të këtij komisioni.